

VENDIM
Nr.365, datë 27.3.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS
QENDËR TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër të qarkut të Beratit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 91 (nëntëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 627 (gjashtëqind e njëzet e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna: Qendër Skrapar

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-214	Toka bujqësore produktive	Në përdorim
492-503 (vetëm kanale të treta)	Toka joproduktive dhe kanale të treta kulluese	Në pronësi
508-538, 540-542	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
543-562	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
563-565	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
566- 586	Varrezat publike	Në pronësi
587-597	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturale e sportive	Në pronësi
604	Sistemi i largimit të ujërave të zeza	Në pronësi